



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:304626
Datë: 14.11.2025
Numri i dokumentit: 08062386

KF.nr.731/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, gjyqtarja Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Albi Commere” ShPK, me numër unik identifikues 810443424 me seli në Veternik-Prishtinë, p.n., të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekti i kontestit vlerësim tatimor, vlera e kontestit 219,972.67€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Blerim Prestreshi dhe përfaqësuesit të palës së paditur Agron Ndrecaj, me datë 31.10.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Albi Commerce” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810443424, me seli në Veternik, Prishtinë, p.n.
- II. ANULOHET Aktvendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës, me nr. 493/23, datë 15.12.2023, me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit “Albi Commerce” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810443424, me seli në Veternik, Prishtinë, p.n., t’ia kthejë shumën prej 219,972.67 € (dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent), të paguar në emër të tatimit shtesë në të ardhura të korporatave (TAK), së bashku me interesin ligjor të llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për çdo muaj kalendarik nga data e pagesës së bërë nga tatimpaguesi e deri në datën kur Administrata Tatimore e Kosovës i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë vetë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi “Albi Commerce” ShPK, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 29.12.2023, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anuloj si të pabazuar aktvendimin e të paditurës nr.493/23 të datës 15.12.2023 dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kthej mjetet financiare të marra pa të drejtë me kamatë ligjore e të gjitha brenda afatit ligjor nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Si në padi ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit ka theksuar se detyrimi nga raporti i kontrollit prej 219,972.67€ ka ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të nenit 4.4 të Ligjit për sponsorizimin, i cili përcakton se pranuesi i sponsorizimit dorëzon vërtetim ose dëshmi për sponsorizimin e pranuar. E paditura gabimisht ka konstatuar se paditësi nuk ka siguruar vërtetimin sipas rregullores MKRS 01/2018. Ky interpretim bie ndesh me nenin 4.4 pasi dëshmitë janë alternative. Në shkresat e lëndës ekzistojnë kontratat e noterizuara dhe transaksionet bankare që vërtetojnë sponsorizimin për Federatën e Futbollit të Kosovës dhe dy klube të njohura që dëshmojnë mbrojtjen e interesit publik sipas nenit 16. Ligji thekson se vërtetimi sigurohet nga pranuesi, por mënyra është alternative, andaj me dëshmitë mbi transaksionet provohet se sponsorizimi ka ndodhur. Rregullorja 01/2018 rregullon vetëm formën dhe procedurën e lëshimit të vërtetimit. Çështja ka të bëjë me interpretim të gabuar të ligjit dhe provat e bashkangjitura janë të mjaftueshme. ATK nuk e ka kontestuar faktin e sponsorizimit apo pagesës, por vetëm mungesën e vërtetimit. Akti administrativ është bërë në kundërshtim me dispozitat e LPA-së. Nevojitet administrimi i provës nëse ka pasur kërkesë për lëshim të vërtetimit nga shfrytëzuesi dhe cilat janë arsyet në MKRS, prandaj ka propozuar dëgjimin e përfaqësuesve të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe zyrtarit të MKRS-së.

Më pas, gjykatës i ka propozuar që zyrtarisht të kërkohet sqarim nga MKRS lidhur me kërkesat e parashtruara për sponsorizim. Gjithashtu ka shtuar se padia është iniciuar mbi bazën e dëshmisë-transferit bankar për Federatën e Futbollit të Kosovës, KF Ballkani dhe KF 2 Korriku. Pas mospranimit të përgjigjes zyrtare nga MKRS, gjykatës i ka propozuar administrimin e provave ekzistuese, pasi MKRS nuk është përgjigjur pavarësisht kërkesave të datës 03.10.2025 dhe 20.10.2025. Ka shtuar se MKRS ka pranuar kërkesat për vërtetim, por nuk ka lëshuar vërtetim brenda 15 ditëve, andaj sipas nenit 100 të LPPA kërkesat konsiderohen të miratuara në

heshtje. Nga provat është vërtetuar se paditësi ka paguar sponsorizimet në bazë të kontratave dhe transferet bankare për Federatën e Futbollit të Kosovës, KF Ballkani dhe KF 2 Korriku. Neni 4 par. 4 përcakton se pranuesi dorëzon vërtetim ose dëshmi, pra detyrime alternative. Gjykata ka administruar transferet bankare dhe tri kërkesa për vërtetim dorëzuar në MKRS, e cila nuk ka lëshuar vërtetimet brenda afatit. Në bazë të nenit 100 të LPPA, kërkesat janë miratuar në heshtje. Me provat e administruara u vërtetua se paditësi ka përmbushur detyrimet ligjore, ndërsa e paditura pa bazë ligjore ka refuzuar t'i njohë të drejtat tatimore, duke cenuar sigurinë juridike të paditësit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit të precizuar më 29.09.2025, si të bazuar.

Për shpenzime procedurale nuk është deklaruar.

E paditura në përgjigje në padi ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke i propozuar gjykatës që të refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin kontestues.

Përfaqësuesi i të paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka qëndruar pranë deklarimeve sipas përgjigjes në padi. Ka shtuar se ATK kundërshton deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit pasi neni 16 i ligjit 05/L-090 për sponsorizim përcakton se me kërkesë të shfrytëzuesit ministria lëshon vërtetimin. Ky ligj zbatohet sipas rregullores 01/2018 që përcakton dorëzimin e vërtetimit në ATK, të cilin paditësi nuk e ka pasur, andaj nuk i është njohur e drejta për zbritje. Neni 11 përcakton se vërtetimi duhet të përmbajë shënimet nga paragrafi 1.1 deri 1.12 dhe të nënshkruhet e vuloset nga MKRS. Marrë parasysh këto kritere standarde, çdo biznes duhet t'u përmbahet atyre përndryshe nuk i njihet e drejta, si në rastin konkret. Çdo pretendim tjetër nga përfaqësuesi i paditësit është irelevant dhe në kundërshtim me dispozitat.

Gjithashtu ka theksuar se pretendimi se paditësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas nenit 4 paragrafi 4, duke u bazuar në dëshmitë e pagesës, nuk qëndron pasi neni 16 i ligjit parashikon vërtetimin si kusht për zbritje tatimore. ATK kërkon këtë vërtetim në bazë të ligjit dhe rregullores 01/2018 dhe është detyrë e paditësit të dorëzojë dokumentet për të përfituar zbritjen. Pretendimi për fitim të së drejtës në heshtje administrative nuk qëndron, pasi MKRS për shkak të kërkesave të mëdha dhe mungesës së stafit nuk ka lëshuar vërtetimet me kohë. Pretendimi se pagesa është e mjaftueshme është në kundërshtim me kriteret ligjore. ATK mbetet pranë përgjigjes në padi të

datës 13.11.2024 dhe deklarimeve të dhëna, duke kërkuar nga gjykata që pas shqyrtimit të provave të marrë aktgjykim me të cilin refuzohet padia dhe të mbetet në fuqi vendimi nr. 493/2023 i datës 15.12.2023 i ATK-së.

Për shpenzime të procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë të provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 31.10.2025, ka administruar provat si në vijim: Vendimi kontestues nr. 493/23 datë 15.11.2023, Ankesë në DA datë 13.11.2023, Raport i kontrollit datë 25.10.2023, Kontratë për sponsorizim 29.12.2022 dhe aneks kontrata e noterizuar me nr. LRP.nr 666/23, Raport narrativ i datës 30.06.2023, Raport i datës 17.08.2023, Kontratë datë 18.02.2022, Transaksion bankar datë 05.09.2022 me nr. të referencës 00020749 dhe i datë 30.12.2022 me nr. 00015996, Kontratë e datës 27.12.2022, Dy transaksione bankare të datës 30.12.2022 me nr. 00014127 dhe nr. 00014265, Përgjigje në padi e datës 13.11.2024, Tri kërkesa për vërtetim: të datës 30.12.2022 me nr. të protokollit të MKRS 6793/2022, e datës 27.12.2022 me nr. të protokollit 6482/2022 dhe e datës 09.09.2022 me nr. të protokollit 4049/2022, Kërkesat për verifikim drejtuar MKRS-së dhe konfirmimi i datës 14.10.2025.

Gjykata, pasi vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, pretendimet në padi e përgjigje në padi dhe të gjitha shkresat e lëndës, duke vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, në pajtim me nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar-administrativ duhet vendosur si në dispozitiv, për arsye të mëposhtme:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar-administrativ, përfshirë deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, aktvendimin kontestues dhe deklaratimet gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, gjykata ka konstatuar se nuk ishte kontestues fakti se e paditura ka realizuar kontroll tatimor për periudhën TAK/2022, ndërsa arsyeja e kontrollit ishte mosplotësimi i të gjitha procedurave dhe kriterëve ligjore për sponsorizimet e dhëna për qëllime të mbështetjes së sportit/kulturës, bazuar në Ligjin nr. 05/L-090. Kontrolli ka rezultuar me tatim shtesë në TAK/2022 në shumë prej 219,972.67 €.

Ndaj raportit të kontrollit paditësi kishte ushtruar ankesë, të cilën Departamenti i Ankesave me aktvendimin nr. 493/23 e ka refuzuar. Paditësi këtë vendim e ka atakuar me këtë padi, duke iniciuar këtë konflikt tregtar-administrativ.

Kontestuese ndërmjet palëve ishte nëse e paditura ka vepruar drejt kur nuk i ka njohur zbritjet për sponsorizimet në fushën e sportit.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit me arsyetimin se Departamenti i Ankesave ka konstatuar se pretendimi i tatimpaguesit është i pabazuar, pasi kontrolli tatimor është zhvilluar në përputhje me Ligjin nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Sipas nenit 16 të këtij ligji, vërtetimi për sponsorizim lëshohet nga MKRS me kërkesë të shfrytëzuesit dhe përbën bazën për njohjen e sponsorizimit si interes publik dhe për përfitimin e zbritjes tatimore.

DA thekson se dëshmitë e pagesës nuk zëvendësojnë vërtetimin dhe se për të përfituar nga zbritja tatimore, tatimpaguesi duhet të dorëzojë në ATK dokumentet përkatëse të lëshuara nga MKRS, në pajtim me Rregulloren 01/2018 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vërtetimin e sponsorizimit.

Në mungesë të këtij vërtetimi, ATK nuk është e obliguar të aplikojë zbritjen nga tatimi për sponsorizime, pasi dorëzimi i tij është detyrim ligjor. DA ka vlerësuar se vendimi i ATK-së është i bazuar në ligj dhe në përputhje me nenin 77.2 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe me nenin 132.2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga ajo që e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ.

Gjykata konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga paditësi mjafton për të dëshmuar se janë përmbushur kushtet për zbritjen e tatimit, kjo për faktin se dispozitat ligjore të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave në nenin 11 përcaktojnë se: *“Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit që mbajnë libra dhe regjistrime sipas paragrafit 5 të nenit 35 të këtij ligji, në formë të donacionit dhe sponsorizimeve për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas këtij ligji, konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut. Kontributet e dhëna*

nga tatimpaguesit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Një kontribut i lejueshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet t'i bëhet një organizate të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi mbi themelimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare që ka pranuar dhe mbajtur statusin e beneficuar publik, ose çdo organizate tjetër që në mënyrë të drejtpërdrejtë kryen aktivitete me interes publik, siç janë institucionet shëndetësore, institucionet edukativo-arsimore, organizatat për mbrojtjen e mjedisit, institucionet fetare, institucionet që përkujdesen për persona me nevoja të veçanta apo për persona të moshuar, jetimoret dhe institucionet në përkrahje të shkencës, kulturës, sportit apo të arteve. Zbritja e lejueshme nuk përfshin kontributin nga i cili direkt apo indirekt përfitojnë donatorët ose personat e afërm me donatorin. Secili tatimpagues që kërkon zbritje të lejueshme duhet t'i paraqesë ATK-së dëftesën e pagesës për një zbritje të tillë. Përveç zbritjes së lejuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesit që do të kontribuojnë në fusha të caktuara do të kenë një lejim special deri në dhjetë përqind (10%) nëse parashihen me ligje të veçanta në Kosovë. Për zbatimin e këtij neni Ministri nxjerr akt nënligjor.”

Ndërsa, në Udhëzimin Administrativ 02/2016 për zbatimin e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, neni 14 paragrafi 1 dhe 2 parashihet: ” 1. Limiti i lejuar prej dhjetë përqind (10%), siç është përcaktuar në nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit, për kontributet e dhëna nga tatimpaguesi për interes publik, aplikohet në fitimin para tatimit, përpara se një shpenzim i këtillë të jetë zbritur nga të ardhurat e rregulluara bruto. 2. Tatimpaguesi i cili kërkon zbritje të shpenzimeve në lidhje me kontributin bamirës të dhënë gjatë periudhës tatimore, siguron fletë-dëshminë e pagesës së nënshkruar dhe vulosur nga ana e përfituesit të kontributit bamirës, që vërteton qëllimin, shumën dhe kohën e donacionit të dhënë.”

Tutje, Ligji Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, në nenin 4 paragrafi 4 përcakton: “Për sponsorizimet në përputhje me këtë ligj, me kërkesë të dhënësit, pranuesi i sponsorizimit dorëzon vërtetim ose dëshmi për sponsorizimin e pranuar. Forma dhe mënyra e përpilimit të vërtetimit apo dëshmisë, si dhe procedura e lëshimit të saj përcaktohet nga Ministria me akt nënligjor.”

Ndërsa në nenin 16 është rregulluar Mbrojtja e interesit publik, ku decidivisht parashihet se: “Me kërkesë të shfrytëzuesit të sponsorizimit, Ministria lëshon vërtetim në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, me të cilin vërteton se sponsorizimi në fushën e

kulturës, rinisë dhe sportit është interes i përgjithshëm publik i përcaktuar me këtë ligj dhe sipas nenit 10 të Ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Ministria, në afatin e paraparë, kërkon sqarim për secilën kërkesë të paraqitur, në bazë të kompetencave të veta nga organet përkatëse mbikëqyrëse.”

Nga analiza e dispozitave të lartcekura rezulton se neni 4 paragrafi 4 i Ligjit për Sponsorizime përcakton se *“pranuesi i sponsorizimit dorëzon vërtetim ose dëshmi”*, çka në kuptimin gjuhësor të termit ose krijon dy forma të mundshme provimi të faktit të sponsorizimit.

Neni 16 i po këtij ligji rregullon procedurën për njohjen e sponsorizimit si interes publik, duke kërkuar që MKRS të lëshojë vërtetim brenda 15 ditëve. Ky vërtetim lidhet me vlerësimin e interesit publik, jo me vetë ekzistencën e sponsorizimit.

Neni 11 i Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave njeh si të zbritshme kontributet për aktivitete me interes publik, përfshirë sportin dhe kulturën, deri në 10% të të ardhurave tatueshme, me kusht që tatimpaguesi të paraqesë dëftesën e pagesës. Po ashtu, edhe UA 02/2016 parasheh që tatimpaguesi duhet të siguroj fletë-dëshminë e pagesës së nënshkruar dhe vulosur nga ana e përfituesit të kontributit bamirës, që vërteton qëllimin, shumën dhe kohën e donacionit të dhënë.

Duke qenë se MKRS nuk ka lëshuar vërtetimin brenda afatit ligjor, aplikimi i nenit 100 të LPPA-së është i arsyeshëm, pasi kjo dispozitë lidhur me mosveprimin e organit brenda afatit sjell efektin e *“miratimit në heshtje”*, për aq sa ligji nuk e ndalon shprehimisht këtë. Ligji për sponsorizime nuk përmban ndalesë të tillë.

Ndonëse Gjykata, në mënyrë zyrtare, ka kërkuar nga MKRS sqarime lidhur me kërkesat e paraqitura nga paditësi, pavarësisht konfirmimit të pranimit të kërkesës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata, e njëjta nuk ka ofruar sqarime as deri në marrjen e këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara dhe dispozitat e zbatueshme rezulton se paditësi ka provuar ekzistencën e sponsorizimeve përmes kontratave të noterizuara dhe transaksioneve bankare, të cilat janë në përputhje me kërkesat e nenit 4 të Ligjit për Sponsorizime dhe nenit 11 të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, ndërsa mungesa e vërtetimit formal nga MKRS nuk mund të cenojë të drejtën materiale të paditësit për zbritje, kur provat dokumentojnë realisht pagesën

dhe qëllimin e sponsorizimit publik. Aq më tepër kur moslëshimi i vërtetimit brenda afatit 15-ditor nga MKRS duhet të konsiderohet miratim në heshtje, në kuptim të nenit 100 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, refuzimi i ATK-së për njohjen e zbritjes tatimore është bërë në interpretim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke cenuar parimin e sigurisë juridike të tatimpaguesit.

Gjykata vlerëson se aktvendimi nr. 493/23 i ATK-së nuk është i bazuar në mënyrë të drejtë në ligj, sepse nuk është marrë në konsideratë karakteri alternativ i provave sipas nenit 4.4 të Ligjit për Sponsorizime, është anashkaluar efekti juridik i nenit 100 të LPPA-së dhe nuk është zbatuar në mënyrë të harmonizuar me nenin 11 të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 përcaktohet se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*, ndërsa me nenin 7 par 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse.

Vendimmarrja e Gjykatës në konfliktin administrativ është e rregulluar me nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin përcaktohet : 1. *Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim. 2. Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar. 3. Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar. 10 4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar. 5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.*

Në mbështetje të nenit 46 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, Gjykata aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, e anulon aktvendimin e kontestuar të Administratës Tatimore të Kosovës dhe e obligon të paditurën t'ia kthejë paditësit shumën prej 219.972.67 euro të paguar më tepër për tatimin shtesë në të ardhurat e korporatave për periudhën 2022.

Në lidhje me kamatën gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit në pajtim me dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA).

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.731/23 datë 31.10.2025

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Dhomave të Shkallës së Dytë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.